



NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND PUNE

Datë 15/04/2019

Në zbatim të Ligjit nr.16, date 18/04/2018 “Për diasporën”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën nr. 469, datë 26.07.2018 si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QBD do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” konkursin për pozicionin:

Specialist Përkthimi në Sektorin e Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes pranë QBD-së

Kategoria e pagës për këtë pozicion është IV-a.

Përshkrimi përgjithësues i punës në këtë pozicion:

1. Është përgjegjës për përkthimet dhe redaktimet e përkthimeve në gjuhë të huaj, veçanërisht në gjuhë angleze, të dokumentacionit të nevojshëm të QBD-së për aplikimet në projektet ndërkombëtare;
2. Mbikëqyr redaktimin e botimeve dygjuhëshe;
3. Mbikëqyr hartimin dhe përkthimin e shkresave zyrtare në gjuhë të huaja;
4. Përkthen nga gjuha angleze në shqip ose anasjelltas informacione të nevojshme, lajme, artikuj apo njoftime që kanë lidhje me diasporën me qëllim pasurimin e faqes së internetit të QBD-së;
5. Raporton dhe përgjigjet te përgjegjësi i sektorit për të gjitha detyrat e kryera; Raporton me shkrim mbi veprimtarinë vjetore, brenda përfundimit të vitit.
6. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprori direkt apo Drejtori i QBD-së në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda objektivave të punës së tij.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e konkurimit publik:

Të jetë shtetas shqiptar;

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;

Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;

Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;

Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;



Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:

- a - Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja;
- b - Të kenë të paktën 2 vite përvojë pune;
- c - Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- d - Të ketë njohuri shumë të mira në një gjuhë të dytë: franceze, gjermane, italiane ose greke.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

Jetëshkrimi CV;

Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;

Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave të bëhet brenda datës 26/04/2019, në Zyrën e Protokollit të QBD-së pranë Kryeministrisë dhe në postën elektronike të QBD-së info@qbd.gov.al

Në datën 30/4/2019, QBD do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për të vijuar me testimin, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për tu futur në dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga QBD për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuri mbi Ligjit nr.16, date 18/04/2018 "Për diasporën";
- Njohuri mbi VKM nr. 469, date 26.07.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën";
- Njohuri mbi Ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to";
- Njohuri mbi ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006. "Për librin në Republikën e Shqipërisë"



Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e konkurimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Qendra e Botimeve për Diasporë (QBD) do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Shtetit për Diasporën,. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QBD-ja, për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.